



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 dhjetor 2019
Nr. ref.:RK 1493/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI112/18

Parashtrues

Mehrije Rexha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
të Kosovës ARJ-UZVP. nr. 43/2018 të 26 qershorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Mehrije Rexha me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës) e përfaqësuar nga Hasan Rexha, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP. nr. 43/2018, të 26 qershorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafin 5 të nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], si dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 6 gusht 2018, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 3 shtator 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 11 dhjetor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Lidhur me rastin pranë nesh, janë zhvilluar tri sete të procedurave.

Vendimet në procedurë kontestimore

10. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi për vërtetimin e pronësisë së lokalit afarist i cili gjendet në rrugën “Nënë Tereza” nr.49/10 në Prishtinë, me sipërfaqe prej 135,45 m² (në tekstin e mëtejme: lokali afarist), duke marrë për bazë një kontratë të shitblerjes të 12 marsit 1999. Si palë e

paditur në këtë padi ishte Ndërmarrja Publike Banesore (në tekstin e mëtejme: NPB).

11. Më 22 mars 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin C.nr.602/04 aprovoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi se parashtruesja është pronare e lokalit afarist. Pronësia u vërtetua në bazë të kontratës për shitblerjen e patundshmërisë të 12 marsit 1999 të cilën parashtruesja e kishte ofruar si provë në Gjykatën Komunale. Si rrjedhojë, Gjykata Komunale, obligoi NPB-në t'ia njohë të drejtën e pronësisë parashtrueses së kërkesës dhe t'ia mundësojë evidentimin e lokalit afarist në librat kadastralë.

Vendimet lidhur me procedurën penale

12. Më 7 shkurt 2007, Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë, me aktakuzën PP.nr.4064-4/2006 si dhe propozim akuzën 796-11/2007 të 16 shkurtit 2007, e akuzoi parashtruesen e kërkesës për veprën penale *“legalizim i përmbajtjes së pavërtetë”*.
13. Më 19 shkurt 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin P.nr.219/07 shpalli parashtruesen e kërkesës fajtores për kryerjen e veprës penale *“legalizim i përmbajtjes së pavërtetë”* për të cilën parashtruesja u dënua me burg me kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, i cili dënim iu zëvendësua me gjobë në shumën prej 1,350 Euro.
14. Gjykata Komunale në Prishtinë arsyetoi se: *“[parashtruesja e kërkesës] ka vu në lajthim me përmbajtjen e dokumenteve të pavërteta Gjykatën Komunale në Prishtinë e cila në bazë të atyre dokumenteve si organ kompetent ka lëshuar aktgjykimin C.nr.602/04[...].”* Nga provat ishte vërtetuar se parashtruesja e kërkesës kishte prezantuar *“[...] dokumente me përmbajtje të pavërtetë”* dhe se kontrata për shitblerjen e lokalit afarist e 12 marsit 1999 *“[...] ka parregullsi si forma e kontratës dhe llogaritja e çmimit nuk përputhen, nënshkrimi në kontratë i dyshimtë, në libër të protokollit ka përmirësime si dhe në kontabilitetin e NPB-së nuk ka kurrfarë pagese që është bërë nga [parashtruesja e kërkesës] në bazë të kësaj kontrate.”*
15. Gjykata Komunale në Prishtinë gjithashtu duke u bazuar në nenin 114 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPPRK), anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.602/04 të 22 marsit 2006 si dhe anuloi kontratën për shitblerje të lokalit afarist të 12 marsit 1999. Të dëmtuarit NPB dhe S.R. (e cila në këtë procedurë ishte paraqitur si palë e dëmtuar e cila pretendonte se ishte pronare e lokalit afarist), u udhëzuan në kontest të rregullt civil juridik për realizimin e kërkesave pasurore juridike.
16. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal.
17. Më 24 shkurt 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë përmes Aktgjykimit AP.nr.468/2007 konstatoi se ankesa e parashtrueses së kërkesës është e

pabazuar. Gjykata e Qarkut duke iu referuar në hollësi gjendjes faktike, arsyetoi si në vijim: *“[gjykata e shkallës së parë] drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal kur ka gjetur se në veprimet e [parashtrueses së kërkesës] sajohen të gjitha elementet e veprës legalizim i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334, paragrafi 1 të KPK, prandaj edhe në këtë aspekt ankesat [...] janë të pabazuara”.*

18. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër dy aktgjytimeve të gjykatave të instancave më të ulëta.
19. Më 23 gusht 2010, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Pkl.nr.42/2010 pranoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të bazuar dhe ndryshoi cilësimin juridik të veprës penale nga legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë në vepër penale të falsifikimit të dokumenteve të parapare në nenin 332 paragrafi 1 të KPK. Gjykata Supreme *“refuzoi akuzën ndaj parashtrueses së kërkesës për shkak të parashkrimit absolut pasi që në kohën kur gjykata e shkalles së dytë kishte vendosur lidhur me ankesat për këtë vepër penale (falsifikim i dokumentit) kishte arritur afati i parashkrimit absolut.”*
20. Konkretisht, Gjykata Supreme kishte arsyetuar se veprimet e parashtrueses së kërkesës *“prezantimi i kontratës për shitblerjen e banesës me nënshkrime të falsifikuara në procedurën kontestimore, si provë pa mëdyshje janë antiligjore dhe veprime inkriminuese pasi që kjo kontratë i asaj i ka shërbyer në procedurën kontestimore si provë për pronësinë”.* Si rrjedhojë, Gjykata Supreme arsyetoi se veprimet e parashtrueses së kërkesës nuk mund të cilësohen si *“legalizim i përmbajtjes së pavërtetë”* por si *“falsifikim i dokumentit”*. Gjykata Supreme theksoi se për veprën penale *“falsifikim i dokumentit”* kemi të bëjmë me vepër penale me anë të së cilës është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit, dhe për të cilën parashkrimi relativ është dy vjet ndërsa ai absolut është katër vjet, prandaj konstatoi se në rastin e parashtrueses së kërkesës ishte parashkruar ndjekja penale.

Vendimet në procedurë të konfliktit administrativ

21. Sipas shkresave të lëndës, në një datë të pacaktuar S.R. kishte parashtruar ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, duke kërkuar që të anulohet regjistrimi i lokalit afarist dhe ky lokal të regjistrohet në emrin e saj.
22. Më 14 maj 2012, Agjencia Kadastrale e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: AKK) përmes Aktvendimit 04/252/12 aprovoi ankesën e S.R. dhe e anuloi regjistrimin e kësaj pjese të ndërtesës në Regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme në emër të parashtrueses së kërkesës. Sipas AKK-së, as parashtruesja e kërkesës e as pala tjetër S.R. nuk posedojnë dokumentacionin përkatës për të regjistruar pronën dhe gjithashtu arsyetojnë se sipas nenit 3.4 paragrafit (iii) të Ligjit 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronave të Paluajtshme (në tekstin e mëtejshëm: LTHRDP) është paraparë që kërkesa për regjistrim refuzohet në rastin kur validiteti i kërkesës ose ndonjë nga dokumentet mbështetëse janë në pyetje. Në lidhje me këtë AKK theksoi se validiteti i kontratës për shitblerjen e lokalit afarist është vënë në pikëpyetje nga vendimet gjyqësore në procedurën penale.

23. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi për anulimin e Aktvendimit të lartcekur të AKK-së, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative duke pretenduar se i ishte hequr e drejta e pronës në mënyrë të kundërligjshme.
24. Më 7 mars 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr.813/2012 refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës dhe e la në fuqi aktvendimin e organit te paditur-Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës duke u mbështetur në nenet, 2, 3.2, 3.4 dhe 3.7 të LTHRDP-së si dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr.2004/3. Gjykata Themelore në Prishtinë gjithashtu arsyetoi se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale C.nr.602/04 i 22 marsit 2006 në bazë të cilit është regjistruar paluajtshmëria (lokali afarist) është anuluar me Aktgjykimin penal të Gjykatës Komunale në Prishtinë P.N219/07 të 19 qershorit 2007, dhe citon paragrafin II të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme P.nr.42/2010 të 23 gushtit 2010 e cila “ *e aprovon kundërshtimin e palës vetëm(parashtrueses se kërkesës) sa i përket ndjekjes penale për shkak të parashkrimit absolut ndërsa në paragrafin II të këtij aktgjykimi vlerëson se veprimet si prezantimi i kontratës për shitblerjen e banesës nga ana e Mihrije Rexhes, përbëjnë elemente të veprës penale të falsifikimit të dokumentit sipas nenit 332 paragrafi 1 te KPK-se. Andaj nga kjo paditëses i është refuzuar e drejta e regjistrimit të pronës së lartcekur në rexhistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshëm sipas nenit 3.4 paragrafi (iii) të Ligjit nr.202/5 ”.*
25. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit A.nr.813/2012 të Gjykatës Themelore të Prishtinës.
26. Më 12 gusht 2017, Gjykata e Apelit e Kosovës përmes Aktgjykimit AA.nr. 189/2017, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, duke aprovuar në tërësi qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit *ndër të tjera* arsyetoi se “*prova në të cilën e bazon të drejtën e vet [parashtruesja e kërkesës] si kontrata mbi shitblerjen e [lokalit afarist] nuk është valide, ky fakt është vërtetuar në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë P.N.nr.219/07, me të cilin është anuluar Aktgjykimi i gjykatës së njëjtë [...]*”.
27. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm kundër Aktgjykimit AA.nr.189/2017 të Gjykatës së Apelit.
28. Më 26 qershor 2018, Gjykata Supreme e Kosovës përmes Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr.43/2018, refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të parashtrueses së kërkesës me arsyetimin se neni 3.2 i LTHRDPS-së kërkon që parashtruesi të bashkëngjisë dokumentacion përkatës për të mbështetur të drejtën e pronës. Gjykata Supreme iu referua dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 2004/3 i cili përcakton bazën ligjore për regjistrim dhe i cili bazohet në dokument valid nga një organ kompetent dhe një transaksion ligjor që përputhet me dispozitat e ligjit në fuqi.

29. Në fund, Gjykata Supreme arsyetoi se parashtrueses së kërkesës me të drejtë iu refuzua kërkesa për anulimin e vendimit të AKK-së nga gjykatat e instancave më të ulëta sepse parashtruesja e kërkesës *“nuk ka prezantuar dëshmi valide”* dhe lidhur me kontratën e shitblerjes *“është konstatuar se përmban elemente të veprës penale të falsifikimit”* sipas Aktgjykimeve të gjykatave të rregullta në procedurë penale.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

30. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me anë të vendimit të kontestuar i është shkelur e drejta e saj e garantuar me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafin 5 të nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], si dhe paragrafët 1-4 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
31. Më tej, parashtruesja e kërkesës pretendon se janë shkelur edhe nenet *“1, 2, 4, 8, 10, 20 dhe 37 të Ligjit Themelor mbi Marrëdhëniet Pronëso-ro-Juridike; dispozitat e neneve 38, 39 dhe 97 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore; Neni 3.2 i Ligjit nr.2012/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme; neni 4, i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2012/05, për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.”*
32. Parashtruesja e kërkesës fillimisht pohon se Agjencia Kadastrale e Kosovës me Aktvendimin 04/252/12 ia ka hequr asaj, jashtë çdo procedure dhe në mënyrë arbitrare, titullin e pronësisë.
33. Parashtruesja e kërkesës, e ndërlidhë pretendimin e lartcekur me faktin që sipas saj Gjykata Supreme me Aktgjykimin UZVP.nr.43/2018 të 26 qershorit 2018 ka shkelur të drejtën e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për faktin se nuk e ka marrë për bazë që aktakuza ndaj saj është refuzuar. Tutje, parashtruesja e kërkesës pohon se sipas parimit *“in dubio pro reo”*, çdo person i dyshuar për vepër penale, konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë dhe sipas saj *“[...] aktgjykimet e cekura nga Gjykata Supreme janë ndryshuar dhe si të tilla nuk paraqesin ndonjë provë lidhur me përgjegjësinë penale.”*
34. Parashtruesja thekson se ajo në fakt nuk është gjykuar dhe nuk është shpallur fajtores, prandaj pretendon se ekziston shkelja kushtetuese për faktin se ndaj saj është refuzuar aktakuza ndërsa Gjykata Supreme gjatë arsyetimit *“ka theksuar se [parashtruesja] është shpallur fajtores në procedurë penale dhe për këtë duhet të i hiqet titulli i pronësisë.”*
35. Parashtruesja tutje pretendon se instanca e njëjte gjyqësore në procedurë penale nuk mundet të anulojë aktgjykimin e formës së prerë të instancës së njëjte dhe që këtë mund ta bëjë vetëm instanca gjyqësore më e lartë.
36. Parashtruesja e kërkesës pohon se *“[...] nuk mund të ketë elemente të veprës penale ose gjykim të çështjes në rastin e refuzimit të aktakuzës [...].”*

37. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme ARJ-UZVP.nr.43/2018 dhe të njëjtin t'ia kthejë Gjykatës Supreme për rishqyrtim.

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI NR. 2002/ 5 PËR THEMELIMIN E REGJISTRIT TË TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 04/L-009 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2002/ 5 PËR THEMELIMIN E REGJISTRIT TË TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME

Neni 2

[Të drejtat e pronave të paluajtshme]

2.1 Të drejtat e pronave të paluajtshme, ashtu siç rregullohen me dispozitat e ligjeve ne fuqi, që i takojnë tokës, ndërtesave dhe banesave (në tekstin e mëtejshëm: "pronat e paluajtshme") do të regjistrohen në Regjistër.

2.2 Të drejtat e pronave të paluajtshme përfshijnë:

- a. pronësinë;*
- b. hipotekat;*
- c. servitutet; [...]*

Neni 3

[Regjistrimi i të drejtave të pronave të paluajtshme]

3.1 Kërkesat për regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme i parashtrohen me shkrim ZKK-së në territorin ku ndodhet prona e paluajtshme. ZKK-ja do të konfirmojë datën dhe kohën e pranimit të kërkesës për regjistrim.

*3.2 Parashtruesi që kërkon regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme, kërkesës duhet t'ja bashkangjes dokumentacionin përkatës për të mbështetur të drejtën e pronës së paluajtshme siç kërkohet me ligjin në fuqi të përcaktuar me nenin 3.7 të këtij ligji.
[...]*

3.4 ZKK-ja e refuzon regjistrimin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i mjaftueshëm të provojë se parashtruesi i kërkesës është bartës i:

- (i) të drejtës së pronës së paluajtshme, të kërkuar për regjistrim;*
- (ii) nëse kërkesa dhe dokumentet mbështetëse përmbajnë parregullsi të dukshme;*
- (iii) nëse validiteti i kërkesës ose ndonjë nga dokumentet mbështetës është në pyetje; dhe*
- (iv) nëse dokumentacioni nuk është i kompletuar dhe nuk paraqet bazë për regjistrim.*

[...]

3.7 Të drejtat mbi pronën e paluajtshme që parashihen sipas nenit 2 të ligjit regjistruhen në bazë të:

- a). vendimit të plotëfuqishëm të gjykatës;
- b). vendimit të organit administrativ shtetëror;
- c). kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuar nga organi kompetent;
- d). vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit;
- e). vendimit të Komisionit për rindërtimin e kadastrit;
- f). vendimit të Komisionit për rregullimin e tokave; dhe
- g). dokumentit tjetër që me ligje të veçanta parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV MSHP Nr. 2004/03 – PËR ZBATIMIN E LIGJIT MBI THEMELIMIN E REGJISTRIT PËR TË DREJTAT NË PRONËN E PALUAJTSHME

Neni 5

[Baza Ligjore për Regjistrim]

5.1 Regjistrimi i një të drejte mbi pronën e paluajtshme mund të bazohet në:

- i) dokument valid nga një organ kompetent (gjyqësor ose administrativ)
- ii) vendim përfundimtar nga gjykata kompetente;
- iii) me një transaksion ligjor, që përputhet me dispozitat e ligjit në fuqi.

KODI I PËRKOHSHËM I PROCEDURËS PENALE I KOSOVËS

Neni 114

Kur kërkesa pasurore juridike ka të bëjë me anulimin e veprimit të caktuar juridik, kurse gjykata çmon se kërkesa është e bazuar, me aktgjykim e urdhëron anulimin e plotë ose të pjesërishtëm të atij veprimi juridik me pasojat që rrjedhin nga veprimi i tillë, pa cenuar të drejtat e personave të tretë.

Pranueshmëria e kërkesës

- 38. Gjkata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
- 39. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

40. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. *Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
2. *Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

41. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ajo pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
42. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 të Rregullores së punës, duke përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (2) i Rregullores së punës, përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

43. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në thelb pretendon se asaj i janë shkelur të drejtat e saj kushtetuese për dy arsye: (i) pretendon shkelje të së drejtës së saj për prezumimin e pafajësisë, siç garantohet me paragrafin 5 të nenit 31 të Kushtetutës sepse sipas saj gjykatat e rregullta nuk kanë marrë

parasysh faktin që aktakuza ndaj saj është refuzuar dhe ajo nuk është e gjykuar dhe nuk është shpallur fajtores për vepër penale, dhe (ii) heqjes në mënyrë arbitrare dhe jashtë çdo procedure të titullit të pronësisë në lokalin afarist, si pasojë e shkeljes së të drejtës së saj për prezumimin e pafajësisë. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pohon që instanca e njëjte gjyqësore në procedurë penale nuk mundet të anulojë aktgjykimin e formës së prerë, përkatësisht Aktgjykimin P.nr.219/07 të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

44. Gjykata fillimisht thekson së në adresimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, ajo do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(i) *Sa i përket pretendimit për të drejtën për prezumimin e pafajësisë siç parashihet me paragrafin 5 të nenit 31 të Kushtetutës;*

45. Gjykata, duke marrë parasysh se esenca e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës ka të bëjë me çështjen e prezumimit të pafajësisë në ndërlidhje me procedurat e konfliktit administrativ, së pari rikujton paragrafin 5 të nenit 31 të Kushtetutës i cili përcakton: *“Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin. Ky nen ndërlidhet dhe me nenin 6 paragrafi 2 të KEDNJ-së i cili përcakton “Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.”*
46. Nisur nga pretendimet e parashtrueses së kërkesës, Gjykata vëren se kjo e fundit ankohet lidhur me setin e vendimeve të nxjerra në procedurën e konfliktit administrativ, përkatësisht ankesat kundër vendimit të AKK-së me anë të cilit është anuluar regjistrimi i lokalit afarist në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme në emër të parashtrueses së kërkesës, mirëpo, parashtruesja e kërkesës e ndërlidh këtë pretendim me setin e procedurave që kanë ndodhur në procedurë penale ku për shkak të institutit të parashkrimit, është marrë Aktgjykim refuzues për të. Andaj Gjykata pretendimin e parë dhe të dytë të parashtrueses do e trajtojë së bashku.
47. Gjykata rikujton praktikën e GJEDNJ-së, e cila përcakton që neni 6 paragrafi 2 i KEDNJ-së ngërthen (i) aspektin e garancisë substanciale dhe (ii) aspektin praktik dhe efektiv, që nënkupton që ka për qëllim mbrojtjen e individëve që janë liruar nga një akuzë penale ose për të cilët procedurat penale janë ndërprerë, nga trajtimi i zyrtarëve apo autoriteteve publike, sikur ata të ishin fajtorë për akuzën e ngarkuar (shih, *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së *Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 25424/09, Aktgjykimi i 12 korrikut 2013, paragrafët 93-94). Ky i fundit ndërlidhet në rastet edhe pasi procedura penale ka përfunduar, me të ashtuquajturat “procedurat pasuese gjyqësore”, (shih *Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 96-97).
48. Gjykata vëren se në rastin e *Vassilios Stavropoulos kundër Greqisë*, GJEDNJ gjeti shkelje të nenit 6 paragrafi 2 për arsye se Gjykatat Administrative e kishin interpretuar në dobi të dyshimit aktgjykimin e gjykatave penale me të cilat është

liruar nga akuza z. *Stavropoulis* dhe nuk kishin marrë parasysh parimin *in dubio pro reo*. Gjykatat Administrative ishin shprehur me terma të tilla që tejkalonin kontekstin administrativ të mosmarrëveshjes dhe nuk kishin lënë asnjë dyshim në lidhje me qëllimin e supozuar të z. *Stavropoulis* për të mos përfshirë në deklaratën e tij të gjitha pronat në pronësi të tij. Prandaj, GJEDNJ gjeti se arsyetimi i tyre ishte i papajtueshëm me parimin e prezumimit të pafajësisë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Vassilios Stavropoulos kundër Greqisë* nr.35522/04, Aktgjykim i 27 shtatorit 2007).

49. GJEDNJ në rastin *Çelik (Bozkurt) kundër Turqisë* përsëriti se fushëveprimi i nenit 6 paragrafit 2 të KEDNJ-së nuk kufizohet në procedurat penale të cilat janë në pritje, por mund të shtrihen në vendimet gjyqësore të marra pas mbarimit të procedurës ose pas lirimit, për aq sa çështjet e ngritura në këto raste janë rrjedhojë dhe shoqërohen me procedurën penale në fjalë, në të cilën parashtruesi ishte "i akuzuari". GJEDNJ në rastin *Çelik (Bozkurt) kundër Turqisë* konsideroi se gjuha e përdorur nga Gjykata Administrative në hedhjen poshtë të çështjes së parashtruesit krijoi një "lidhje" midis çështjes penale dhe procedurave administrative, të cilat justifikojnë zgjerimin e fushëveprimit të nenit 6 paragrafi 2 për të mbuluar këtë të fundit (shih rastin e GJEDNJ-së, *Çelik (Bozkurt) kundër Turqisë*, nr. 34388/05, Aktgjykim i 12 prillit 2011, paragrafi 34).
50. Gjykata, duke marrë parasysh praktikën e GJEDNJ-së dhe duke marrë për bazë rrethanat në rastin konkret, nuk do të ndërlidhet me setin e procedurave penale sepse parashtruesja e kërkesës nuk i konteston ato pranë nesh, por do e trajtojë setin e procedurave të konfliktit administrativ, që kanë ardhur si pasojë e heqjes së titullit të pronësisë të lokalit afarist dhe për të cilat parashtruesja pretendon se i kanë shkelur asaj të drejtën për prezumimin e pafajësisë.
51. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.602/04 të 22 marsit 2006 në procedurë kontestimore kishte fituar titullin e pronësisë në lokalin afarist për shkak të një kontrate për shitblerje të cilën ajo kishte prezantuar në këtë procedurë, por për të cilën ishte konstatuar "*se përmban elemente të veprës penale të falsifikimit*" në procedurat pasuese penale. Si rrjedhojë, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.602/04 i 22 marsit 2006 dhe kontrata e shitblerjes ishin anuluar.
52. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta në procedurën e konfliktit administrativ kishin dhënë arsyet përkatëse lidhur me vendimet e tyre, duke theksuar se LTHRDP përcakton baza të veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme, dhe duke referuar se në rastin e parashtrueses së kërkesës, dokumenti (kontrata e shitblerjes) që ajo kishte paraqitur pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë [Aktgjykimin C.nr.602/04] nuk konsiston në të drejtën e saj pronësore.
53. Për më tepër, sa i përket pretendimit të parashtrueses se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë për bazë faktin se ndaj saj është refuzuar aktakuza dhe se Gjykata Supreme gjatë vendosjes "*ka theksuar se [parashtruesja] është shpallur fajtores në procedurë penale dhe për këtë duhet të i hiqet titulli i pronësisë*", Gjykata rikujton Aktgjykimin e Gjykatës Supreme ARJ-UZVP.nr.43/2018 të 26 qershorit 2018 e cila kishte arsyetuar si në vijim:

“Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e në bazë të dispozitave të ligjit, gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë vërtetuar se paditësja [parashtruesja e kërkesës] gjatë procedurës nuk ka prezantuar asnjë dëshmi valide për të mbështetur pretendimet e veta. Pra kjo Gjykatë konstaton se gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe ligjit material, kur kanë refuzuar kërkesën e paditëses për anulimin e vendimit e të paditurës AKK me nr.04/252/12 dt.14.05.2012, sepse pretendimet e paditëses janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga organi i paditur dhe në kundërshtim me dispozitat e ligjit (LTHRDP) nr.2002/5 si dhe UA nr.2004/3. Kjo Gjykatë vlerësoi si të rregullt qëndrimin e gjykatave të instancës më të ulët lidhur me kërkesën e paditëses [parashtrueses] dhe prezantimit të kontratës për shitblerjen e lokalit afarist nr. 03-750/1 dt.12.03.1999 e në bazë të cilës gjatë procedurës penale para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës është konstatuar se e njëjta përmban elemente të veprës penale të falsifikimit të dokumentit. Ky fakt është vërtetuar në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë PN.(K)nr.219/07 me të cilin është anuluar aktgjykimi i Gjykatës së njëjtë C(P) nr.602/04 dt.22.03.2006.”

54. Nisur nga arsyetimi i mësipërm i Gjykatës Supreme dhe vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta i referohen vetëm kontratës së shitblerjes, dhe faktit që kjo kontratë përmban elemente të veprës penale të falsifikimit të dokumentit. Mirëpo, në asnjë nga vendimet e gjykatave të rregullta, në procedurat e konfliktit administrativ, nuk është prekur çështja e fajësisë apo pafajësisë së parashtrueses së kërkesës. Gjykata Supreme vetëm i kishte sqaruar parashtrueses së kërkesës që *“nuk ka prezantuar dëshmi valide”* dhe kontrata e shitblerjes *“është konstatuar se përmban elemente të veprës penale të falsifikimit”*.
 - (ii) *Sa i përket pretendimit për heqje në mënyrë arbitrare dhe jashtë çdo procedure të titullit të pronësisë në lokalit afarist, për shkak të shkeljes së parimit të prezumimit të pafajësisë;*
55. Gjykata rikujton fillimisht se pretendimi i dytë i parashtrueses së kërkesës lidhur me *“heqjen arbitrare të titullit të pronësisë”*, ndërlidhet me pretendimin e saj për t’u prezumuar e pafajshme, sepse nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Pkl.nr.42/2010] i 23 gushtit 2010, ajo nuk është shpallur fajtores për veprën penale. Lidhur me këtë fakt, parashtruesja po ashtu thekson se *“[...] nuk mund të ketë elemente të veprës penale ose gjykim të çështjes në rastin e refuzimit të aktakuzës [...]”*.
56. Gjykata rikujton se procedura e konfliktit administrativ, ka ndodhur si pasojë e ankesës së personit S.R. në AKK, e cila kishte kërkuar që të anulohet regjistrimi i lokalit afarist në emër të parashtruese së kërkesës dhe ky lokal të regjistrohet në emrin e saj. Si rrjedhojë e ankesës, AKK kishte anuluar regjistrimin e kësaj pjese të ndërtesës në Regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme në emër të parashtrueses së kërkesës, për shkak të mosposedimit të dokumentacionit

përkatës. Gjykata rikujton se personi S.R. kishte qenë e pranishme në cilësinë e palës së dëmtuar në setin e procedurave penale.

57. Gjykata lidhur me këtë pretendim, vëren fillimisht se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj [Pkl.nr.42/2010], kishte refuzuar akuzën ndaj parashtrueses së kërkesës, duke u bazuar në nenin 389 paragrafi 4 të KPPPRK-së i cili thekson si në vijim:

Neni 389

Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur:

4) Ka kaluar afati i parashkrimit dhe vepra përfshihet në amnisti o falje, ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale.

58. Si rrjedhojë Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj [Pkl.nr.42/2010], pranoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtrueses së kërkesës dhe mbi bazën ligjore të lartshënuar, ndryshoi Aktgjykimet e gjykatave më të ulëta, përkatësisht Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë [P.nr.219/2007] të 19 qershorit 2007 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë [Ap.nr.468/2007] të 24 shkurtit 2010, ashtu që ndaj parashtrueses së kërkesës u refuzua akuza (bazuar në nenin 389 paragrafi 4 i KPPPRK-së).
59. Gjykata vëren se në rastet e Aktgjykimit me të cilin refuzohet akuza, gjykatat e rregullta vendosin për procedurën përkatëse, duke u kufizuar vetëm në arsyet e refuzimit dhe jo meritat e rastit. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj [Pkl.nr.42/2010], iu ishte referuar vetëm çështjes së parashkrimit të ndjekjes penale, ndërsa sa i përket veprimeve të parashtrueses së kërkesës si prezantimi i kontratës private për shitblerjen e banesës, me nënshkrime të falsifikuara në procedurë kontestimore, si provë, janë veprime antiligjore, dhe se me këtë është konsumuar vepra penale falsifikim i dokumentit.
60. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj [Pkl.nr.42/2010], thekson:

“Veprimet e [parashtrueses së kërkesës] – prezantimi i kontratës private për shitblerjen e banesës, me nënshkrime të falsifikuara në procedurën kontestimore, si provë, pa asnjë mëdyshje janë anti-ligjore dhe veprim inkriminuese, pasi që kjo kontratë asaj i ka shërbyer në procedurën kontestimore, si provë për pronësinë.

Mirëpo, veprimet e të dënuarës nuk mund të vihen nën normën juridike legalizim i përmbajtjes së pavërtetë, të parashikuar nga neni 334 paragrafi 1 i KPK, për faktin se siç u tha më sipër, në rrethana të këtilla nuk është realizuar asnjëri nga elementet e kësaj vepre penale, por me veprat e saja, pa asnjë mëdyshje, ajo ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumentit të parashikuar nga neni 332 par 1 të KPK.”

61. Tutje, Gjykata vëren se në Aktgjykimin e saj Gjykata Supreme i referohet nenit 457 paragrafi 1 pika 1 lidhur me nenin 389 pika 4 KPPPK-së. Në nenin 457 të KPPPK parashihet:

Neni 457 i KPPPRK

(1) Kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes:

1) Ndryshon vendimin e formës së prerë;

62. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj [Pkl.nr.42/2010], ka ndryshuar aktgjykimet e gjykatave më të ulëta përkatësisht Gjykatës Komunale dhe të Qarkut, të nxjerra në procedure penale. Kjo nënkupton se këto Aktgjykime, sa i përket parashtrueses së kërkesës, janë ndryshuar vetëm sa i përket akuzës, përkatësisht pikës së parashkrimit të ndjekjes penale.

63. Gjykata vëren, se në rastet tjera, sipas nenit 457 paragrafi (1) pika 2), Gjykata Supreme, në rastin e vërtetimit si të bazuar të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes:

2) Në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më të lartë dhe lëndën për vendim të ri ose për rigjykim ia kthen gjykatës së shkallës së parë ose gjykatës më të lartë.

64. Nga kjo rezulton që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Pkl.nr.42/2010] sa i përket anulimit të Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.602/04 të 22 marsit 2006 si dhe kontratën e 12 marsit 1999, për shitblerje të lokalit afarist, nuk është ndryshuar nga Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj [Pkl.nr.42/2010]. Kjo pikë ishte ngritur dhe në argumentet e parashtrueses së kërkesës, e cila thekson se instanca e njëjtë gjyqësore në procedurë penale nuk mund të anulojë aktgjykimin e formës së prerë të instancës së njëjtë.

65. Gjykata me këtë rast, rikujton dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P.nr.219/07 të 19 shkurtit 2007, ku Gjykata Komunale kishte arsyetuar përkitazi me këtë çështje dhe bazuar në nenin 114 të KPPPRK-së kishte anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.602/04 të 22 marsit 2006 si dhe kontratën e 12 marsit 1999, për shitblerje të lokalit afarist.

66. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë dhe të mbështesë pretendimin e saj se si gjykatat e rregullta në setin e procedurave të konfliktit administrativ kanë shkelur paragrafin 5 të nenit 31, të Kushtetutës. Përfundimet e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme në setin e procedurave të konfliktit administrativ mbështesin arsyetimin e tyre në legjislacionin relevant lidhur me çështjen e dokumentacionit për të vërtetuar të drejtën e pronës, duke iu referuar kështu dispozitave relevante të Ligjit nr. 2002/ 5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe Udhëzimit Administrativ mshp nr. 2004/03 – për Zbatimin e Ligjit mbi Themelimin e Regjistrimit për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme, kërkesat ligjore të të cilave, parashtruesja e kërkesës nuk i kishte plotësuar.

67. Gjykata, duke rikujtuar edhe pretendimet e parashtrueses e cila pretendon shkeljen e disa dispozitave ligjore, thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave apo aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Në të vërtetë, është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28).
68. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të argumentojë se si aplikimi i dispozitave ligjore në rastin e saj nga gjykatat e rregullta, kanë rezultuar në shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese.
69. Gjykata gjithashtu konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtrueses së kërkesës me rezultatin e procedurave nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të paraqesë pretendim të argumentueshëm për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis* rasti i GJEDNJ-së, *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005 paragrafi 21).
70. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i 30 qershorit 2009).
71. Më tej, përkitazi me pretendimin e parashtrueses në lidhje me të drejtën e saj për mbrojtje të pronës të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata vë në pah se neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (Shih, *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së, *Van der Mussele kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48 dhe rastin e GJEDNJ-së, *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, Aktgjykimi i 9 tetorit 2003, paragrafi 121).
72. Parashtruesja e kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ vetëm për aq sa vendimet e kontestuar kanë të bëjnë me “pronën” e saj. Brenda kuptimit të kësaj dispozite, “pronë” mund të konsiderohet “pasuria ekzistuese”, duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesja mund të ketë “pritshmëri legjitime” që do të fitojë ndonjë të drejtë pronësore. Por shpresa në njohje të të drejtave pronësore nuk mund të konsiderohet me automatizëm si “pronë”, brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Sikundër që nuk mund të konsiderohet as një kërkesë që pushon të jetë e vlefshme si rezultat i mospërmbushjes së kriterëve ligjore (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Prince Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë*, Aktgjykimi i 12 korrikut 2001, paragrafët 82 - 83, dhe rastin e GJEDNJ-së

Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke, Vendim për pranueshmërinë i 10 korrikut 2002, paragrafi 69 si dhe shih *mutatis mutandis* rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI44/16, *Biljana Topko*, Aktvendim për papranueshmëri i 31 marsit 2017, paragrafi 41 si KI26/18, parashtrues “*Jugokoka*”, Aktvendim për papranueshmëri i 26 shtatorit 2018, paragrafi 49).

73. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat pranë gjykatave të rregullta kanë paraqitur në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht të drejtës së saj për prezumimin e pafajësisë të garantuar me paragrafin 5 të nenit 31 dhe të drejtës për mbrojtjen e pronës të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.
74. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe të rregullit 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 11 dhjetor 2019, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi